# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458035**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë tjetër protestë: Lironi çlirimtarët! \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/19/veteranet-e-uck-se-tjeter-proteste-javen-qe-vjen-lironi-clirimtaret/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 14:54:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 14:53:42 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d7ee67349744c4e49ded1aa8ccaa681c20d09b9780e042179a9f746b7eeb820c` |
| TEKSTI | `11648e01201f232a879791b96ef12d224d9556ad8e43dfe8e9bc8cfcdf8cd686` |
| PAMJA | `f5f8a1669087350480c1dabfb301f4d6a33d1cb02023035e4f44bc1325ccb78e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `79da23c568f13a634a2fc08527e0d7a19815d8ba889e840453de82d91129bf27` |
| E MËPARSHMJA | `79156d2abe66f08f457f23c5002f3462ee23b30ca883c2c609b5722af2e524a4` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/79da23c568f13a634a2fc08527e0d7a19815d8ba889e840453de82d91129bf27`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë tjetër protestë: Lironi çlirimtarët!

16:53 : 19/09/2026 në **RAJONI**




Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pritet të protestojë sërish javën e ardhshme, në kundërshtim me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale.

Nënkryetari i OVL-UÇK-së, Gazmend Syla, ka thënë se vendimi për protestën e radhës pritet të merret në mbledhjen e Kryesisë të hënën.

Syla për KosovaPress ka deklaruar se protestat mund të zhvillohen edhe në komunat ku OVL-UÇK-ja ka degë.

"Do të vazhdojmë me protesta. Besojmë të hënën do të mblidhet Kryesia prapë. Edhe do të marrim vendim për protestën e radhës. Po tash t'ia shohim, ndoshta do t'i ndërrojmë idetë…

Ka mundësi që të mërkurën vendosim me pasë protestë. Por kemi menduar me decentralizua protestën. Ka mundësi me realizua në komuna ku i kemi degët tona që funksionojnë atje", tha ai.

**Lexo edhe:**

Protestë në Vlorë/ Qytetarët kundër muzeut hebraik

Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

Ai ka deklaruar se, nëse shteti e merr seriozisht mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së në procesin e apelit, ai beson se ata do të dalin fitimtarë.

"Ky dënim është dhënë mbi bazën e materialeve që i ka dërguar prokuroria e Serbisë, prokurorisë, Gjykatës Speciale, gjykata i ka marrë për trajtim. Fare nuk ekzistojnë as ato farë shqyrtimet që i thoshin, janë të pabaza krejt.

Provoi me dy-tri raste në njëfarë forme me manipulua me opinion, me thënë, 'shihni, këta jo', edhe njëfarë forme provoj me thënë, këta janë individë, po jo UÇK-ja… Nëse shteti jonë e merr seriozisht, jemi të bindur se në apel do të jemi fitimtarë dhe nuk kemi asnjë dilemë

TË GJITHA


Protestë në Vlorë/ Qytetarët kundër muzeut hebraik
17:10 : 19/09/2026


Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë tjetër protestë: Lironi çlirimtarët!
16:53 : 19/09/2026


A mund ta shkatërrojë njerëzimin inteligjenca artificiale?
16:42 : 19/09/2026


"E godita në zemër…"/ Vrau me thikë gruan, zbardhet dëshmia e Hysni Patushit
16:26 : 19/09/2026


Audiopërgjimi i Ron Yeffet/ Këlliçi: Rama, 12 ditë heshtje për koordinatorin e punëve të pista
16:13 : 19/09/2026


Harta e re territoriale/ Rama shkrin 15 bashki më 8 Tetor
15:56 : 19/09/2026


Shkrumbohet nga zjarri banesa në Bulqizë, bllokohet brenda banori me aftësi të kufizuara
15:39 : 19/09/2026

e merr seriozisht, jemi të bindur se në apel do të jemi fitimtarë dhe nuk kemi asnjë dilemë këtu", deklaroi Syla.

Ai ka kërkuar nga deputetët që të ndryshojnë ligjin për Gjykatën Speciale, në mënyrë që të mundësohet monitorimi i procesit, transmeton Klankosova.tv.

"Neve çka kërkojmë është me pasë një lloj monitorimi të procesit, çka ka ndodhur dhe çfarë do të ndodhë deri në apel. Ju e dini që u bë një padrejtësi shumë e madhe atje. Ju e dini që krejt kjo prokurori, krejt kjo Gjykatë Speciale u furnizua me materiale prej prokurorisë serbe.

Prandaj askush nuk pati mundësi ndonjëherë me monitoruar veç çka po ndodh. Monitorim nuk do të thotë ndërhyrje. Monitorim është me pa me çfarë prova ti i ke dënuar njerëzit, ku i ke marrë ato prova, nga cili shtet… Me amandamentuar ligjin, me i dhënë mundësi shtetit tonë me u interesuar edhe me pas qasjen në monitorim të procesit qysh ka shkuar deri tash, sepse ne duhet.

Apeli do të vendosë në bazë të asaj çfarë ka ndodhur tash, cilat shkelje kanë ndodhur, cilat prova nuk kanë qenë legjitime, se ka plot prova që janë marrë që nuk kanë qenë legjitime fare", thekson ai.

Ndërkaq, Syla ka theksuar se veteranët do të insistojnë në kërkesën për shkarkimin e ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla.

Ai kritikoi heshtjen e saj për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së, derisa shtoi se e njëjta ka dërguar materiale kundër tyre.

Gjykata Speciale më 16 shtator dënoi me 81 vjet burg ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, për siç është thënë, krime lufte.

**Etiketa:** proteste uck

## Lajme të lidhura



**Protestë në Vlorë/ Qytetarët kundër muzeut hebraik**

17:10 : 19/09/2026



**Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?**

10:24 : 19/09/2026



**Djali i Jakup Krasniqit: Kur të përfundojë dënimin, babai mund të mos jetë gjallë**

22:19 : 18/09/2026



**Gruaja simbol e eksodit të Kosovës: UÇK-ja na ndihmoi të shpëtonim**

21:58 : 18/09/2026



**Dënimi i ish-liderëve të UÇK-së në Hagë, qytetarët ngrihen në protestë në Prishtinë**

21:28 : 18/09/2026



**Dita e 111-të e protestës/ Mbyllen fjalimet, nis marshimi i qytetarëve në rrugët e Tiranës**

20:58 : 18/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.